



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 23.1.2020

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE
KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË
QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23 janar 2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. Komisioni caktoi si relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Kulturës.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Marrëveshja që do të ratifikohet ka në fokus zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës, përhapjen e kulturës shqiptare dhe prezantimin e saj në Maqedoninë e Veriut dhe anasjelltas nëpërmjet ngritjes së qendrave kulturore dhe informative, të cilat do të prezantojnë kulturën e shteteve respektive nëpërmjet organizimit të eventeve, ekspozitave, ligjëratave letrare, promovimit në media dhe ofrimit të shërbimeve informative për qytetarët e interesuar të të dyja palëve. Qendrat kulturore dhe informative janë qendra shtetërore dhe mënyra e financimit të tyre do të përcaktohet nga secila palë.

Këto qendra do të funksionojnë nën varësinë e misionit diplomatik të vendeve respektive.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA